Oferta akademike e Departamentit të Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit: Bachelor, Master Profesional, Diplomë Profesionale.

Dr. Florina Pazari

Përgjegjëse e Departamentit të Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve. *Programet e reja te studimit në Departamentin e Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit.*

Departamenti i Turizmit, Mikritjes dhe Rekreacionit është një departament multidisiplinar, aplikativ dhe inovator, ku janë të ndërthurura teoria dhe praktika me kërkimin shkencor dhe trajnimet e vazhdueshme për shërbimet në industrinë e turizmit dhe sektorët ndërlidhur me të. Shtyllat mbi të cilat mbështetet departamenti janë

Studimet universitare dhe pasuniversitare

Kërkimi shkencor i Aplikuar dhe Inovacioni

Kurse dhe çertifikime profesionale

Shërbime për Industrinë e Turizmit

Iniciativa dhe StartUp-e

Programe dhe Projekte

Partneritete dhe Bashkëpunime.

Qëllimi i departamentit është përgatitja e profesionistëve, menaxherëve dhe specialistëve për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të industrisë së turizmit dhe sektorëve ndërlidhur me të, ekspertizë kërkimore dhe shkencore (hartim dhe implementim i projekteve kërkimore dhe shkencore në fushën e turizmit), konsulencë për start up-et e bizneseve turistike dhe sektorëve ndërlidhur me të, trajnim dhe çertifikim në specialitete të veçanta të turizmit, hotelerisë dhe shërbimeve.

Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit në UniBa vjen me tre programe studimi: Bachelor, Master Profesional dhe Diplomë Profesionale.

Bachelor: Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente

Programi i studimeve Bachelor në **"**Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente**",** synon pajisjen e studentëve me njohuri bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e aftësive të veçanta në fushën e menaxhimit dhe marketingut të turizmit, aktiviteteve rekreative dhe eventeve, me objektiv kryesor formimin e specialistëve bazë, të aftë për të punuar si menaxherë në sektorin e turizmit, të aktiviteteve rekreative dhe eventeve.

Nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë strategjikë, ky program jo vetëm që do të mbështesë ndërkombëtarizimin e kurrikulës, por edhe do të kultivojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive me universitete, kompani dhe institucione shoqërore, që t'u mundësojë studentëve të hyjnë dhe të angazhohen në fushat e shumëllojshme profesionale mbarëbotërore, me synimin e thjeshtimit të periudhës së tyre të stazhit/praktikës, të realizimit të përvojës dhe të lehtësimit të punësimit brenda apo jashtë vendit. Programi do të ketë një theks në marrëdhënien e lartë midis studentëve me profesionistët me përvojë dhe ekspertizë, si dhe do të nxisi promovimin e aftësive analitike dhe kërkimore, të cilat mund t'u japin të diplomuarve mundësinë e zbulimit dhe të shfrytëzimit të informacionit për të rritur kapacitet e tyre krijuese dhe drejtuese.

Master Profesional: Menaxhim Turizmi, Mikpritje dhe Rekreacion

Industria e turizmit, si një sektor dinamik, është jashtëzakonisht i larmishëm dhe me një mundësi shumë të madhe punësimi në bizneset dhe sektorët që ndërlidhen me turizmin. Për këtë arsye studimet pasuniversitare në fushën turizmit, janë një mundësi shumë e mirë kualifikimi dhe specializimi duke rritur dhe mundësinë e punësimit. Tendenca është në rritje të kërkesave në fushën e menaxhimit të hotelerisë, konferencave, eventeve, sektorit të turizmit dhe kohës së lirë, argëtimit dhe menaxhimit të shërbimeve të pijeve dhe ushqimit. Masteri profesional në Menaxhim Turizmi, Mikpritje dhe Rekreacion ofrohet në tre profile:

1. *Turizëm dhe Udhëtime*
2. *Mikpritje dhe Hotel, Restorant, Katering (HoReCa)*
3. *Rekreacion dhe Outdoor*

Diplomë profesionale: Operator në Udhëtime, Turizëm dhe Hoteleri

Kërkesat në rritje në strukturat pritëse të turistëve, ka rritur dhe interesin e bizneseve, por jo vetëm, për kualifikimin e punonjësve dhe stafit që janë të punësuar ose dëshirojnë të punësohen në industrinë e udhëtimit dhe turizmit si operator në mikriptje, hotele, restorante dhe katering. Ky program studimi ofron mundësinë e përgatitjes profesionale të punonjësve në fushën e turizmit, me specifikë operator në Udhëtime, Turizëm dhe Hoteleri. Programi ka një total 120 kredite dhe zgjat për një periudhë kohore prej dy vitesh, në fund studentët pajisen me diplomë profesionale.

Academic offer of the Department of Tourism, Hospitality and Recreation: Bachelor, Professional Master, Professional Diploma.

Dr. Florina Pazari

Head of the Department of Tourism, Hospitality and Recreation, Faculty of Social Sciences, Tourism and Sports. New study programs in the Department of Tourism, Hospitality and Recreation.

The Department of Tourism, Hospitality and Recreation is a multidisciplinary, applied and innovative department, which combines theory and practice with research and ongoing training on services in the tourism industry and related sectors. The pillars on which the department is based are:

Undergraduate and postgraduate studies

Applied Research and Innovation

Professional courses and certifications

Services for the Tourism Industry

Initiative and StartUp

Programs and Projects

Partnerships and Collaborations

The purpose of the department is to prepare professionals, managers and specialists to respond to the market demands of the tourism industry and related sectors; research and scientific expertise (design and implementation of research and scientific projects in the field of tourism); consultancy for start-ups of tourism businesses and related sectors; training and certification in specific specialties of tourism, hospitality and services.

The Department of Tourism, Hospitality and Recreation at UniBa comes with three study programs: Bachelor, Professional Master and Professional Diploma.

Bachelor: Management in Tourism, Recreation and Events

The Bachelor study programs in "Tourism Management, Recreation and Events", aim to provide students with basic knowledge on general scientific methods and principles and the formation of special skills in the field of tourism management and marketing, recreational activities and events, with the main objective of training basic specialists, capable of working as managers in the tourism sector, recreational activities and events. Through cooperation with strategic partners, this program will not only support the internationalization of the curriculum, but will also cultivate cooperation and exchange of knowledge with universities, companies and social institutions, to enable students to enter and engage in the fields of various professional professions worldwide, with the aim of simplifying their internship / internship period, gaining experience and facilitating employment within or outside the country. The program will have an emphasis on the high relationship between students with experienced and expert professionals, and will encourage the promotion of analytical

and research skills, which can give graduates the opportunity to discover and use the information to increase their creative and leadership capacity.

Professional Master: Tourism Management, Hospitality and Recreation

The tourism industry, as a dynamic sector, is extremely diverse and with a very large employment opportunity in business and sectors related to tourism. For this reason, postgraduate studies in the field of tourism are a very good opportunity for qualification and specialization, increasing the possibility of employment. The trend is increasing demand in the field of hotel management, conferences, events, tourism and leisure sector, entertainment and management of beverage and food services. Professional Master in Tourism Management, Hospitality and Recreation is offered in three profiles:

1. *Tourism and Travel*
2. *Hospitality and Hotel, Restaurant, Catering (HoReCa)*
3. *Recreation and Outdoor*

Professional degree: Operator in Travel, Tourism and Hospitality

The growing demand in the tourist reception facilities has also increased the interest of businesses, but not only, in the qualification of employees and staff who are employed or want to be employed in the travel and tourism industry as operators in micro-hotels, restaurants and catering. This study program offers the possibility of professional training of employees in the field of tourism, with specific operators in Travel, Tourism and Hospitality. The program has a total of 120 credits and lasts for a period of two years, at the end students are provided with a professional degree.

SHQIP

Barleti Training and Testing Center (BTTC) funksionon si qendër multifunksionale zhvillimi profesional-praktik e Universitetit Barleti, me fokus përgatitjen dhe zhvillimin e aftësive për tregun e punës me kompetenca dhe ekspertizë të gjerë në një serë fushash profesionale. Kjo qendër e organizon aktivitetin e saj nëpërmjet akademive, ku ndër më të rëndësishmet është edhe Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit.

Akademia e Turizmit dhe Rekreacionit, funksionon si strukturë e specializuar në ofrimin e shërbimeve të trajnimeve dhe kurseve me certifikim në fushën e industrisë së turizmit, mikpritjes dhe rekreacionit. Këto kurse trajnimi u ofrohen target grupit të industrisë së turizmit dhe ato ndërlidhur me të dhe u përshtatet atyre që kërkojnë të përmirësojnë ose plotësojnë aftësitë e tyre aktuale, në mënyrë që të përshtaten me këtë sektor me zhvillim të shpejtë dhe në zhvillim.

Kjo strukturë organizohet në njësi ofruese të trajnimeve, kurseve dhe certifikimeve sipas fushave të industrisë:

Menaxhim Turizmi

Shërbime për turistët

Drejtues (Menaxhues) në Mikpritje (Hotele&Restorante)

Kuzhinë dhe shërbime në bar dhe restorant,

Shërbime mikpritje dhe hotelerie

Smart turizëm

Portofoli i kurseve dhe trajnimeve përfshin standartet dhe certifikimet e kërkuara në fushën e Turizmit dhe Rekreacionit, programe formimi profesional me certifikim në lidhje me të mësuarin përgjatë të gjithë jetës si dhe paketa trajnimesh soft skills me certifikim për punonjësit e Industrisë së Turizmit dhe Rekreacionit.

Me anë të programeve të dedikuara, bashkëkohore dhe të personalizuara, infrastrukturën moderne teknike dhe teknologjike, ambiente me kushte komode dhe të përshtatshme, akademia ka arritur që të ndërtojë modele të qëndrueshme suksesi, besueshmërie dhe stabiliteti.

Shërbimet e Akademisë së Turizmit dhe Rekreacionit drejtohen dhe realizohen nga trajnerë, ekspertë dhe konsulentë njohës të anës praktike dhe problematikave të punës në fushën përkatëse të kompetencës dhe ekspertizës.

Akademia transmeton tek pjesëmarrësit standardet më të larta teknike dhe praktike të njohurive, aftësive dhe vlerave më të spikatura profesionale të domosdoshmërisë për sukses në industrinë e Turizmit dhe Rekreacionit.

ANGLISHT

Barleti Training and Testing Center (BTTC) functions as a multifunctional professional-practical development center of Barleti University, with a focus on preparing and developing skills for the labor market with extensive competencies and expertise in a range of professional fields. This center organizes its activity through academies, with the most important, among all, is the Academy of Tourism and Recreation.

The Academy of Tourism and Recreation functions as a specialized structure in providing training services and courses with certification in the field of tourism, hospitality and recreation industry.

These training courses are offered to the target groups of the tourism industry and those related to it and are adapted to those who seek to improve or supplement their current skills, in order to adapt to this fast-growing and developing sector.

This structure is organized in training providers, courses and certifications according to industry fields:
Tourism Management

Tourist Services

Hospitality Manager (Hotels & Restaurants)

Bar and Restaurant services (Cuisine)

Hospitality and Hotel Services and Smart Tourism

The portfolio of courses and trainings includes the required standards and certifications in the field of Tourism and Recreation, Vocational training programs with certification related to lifelong learning as well as soft skills training packages with certification for employees of the Tourism and Recreation Industry.

Through dedicated, contemporary and personalized programs, modern technical and technological infrastructure, environments with comfortable and suitable conditions, the academy has managed to build sustainable models of success, reliability and stability.

The services of the Academy of Tourism and Recreation are managed and realized by trainers, experts and consultants familiar with the practical side and work problems in the respective field of competence and expertise.

The Academy transmits to the participants the highest technical and practical standards of knowledge, skills and the most prominent professional values of the necessity for success in the Tourism and Recreation industry.